REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SARANDË
DREJTORIA E ARSIMIT DHE ADMINISTRIMIT FINANCIAR

Raport mbi përmbylljen e vitit shkollor 2025-2026 dhe masat e marra në institucionet arsimore për vitin e ri shkollor 2026-2027 në drejtim të infrastrukturës, ambjenteve dhe burimeve njerëzore.

Të nderuar Këshilltarë!

Institucioni i Bashkisë Sarandë si cdo vit në prag të fillimit të vitit të ri shkollor merr masat për përgatitjen e infrastruktures dhe kushteve të nevojshme në institucionet arsimore në varësinë e saj. Duke marrë parasysh kërkesat e zakonshme dhe ato më emergjente që vijnë nga këto institucione përgjatë vitit, të cilave Bashkia duke koordinuar punën brenda sektorëve të saj gjen zgjidhje të planifikuar apo të menjëhershme.
Muaji qershor 2026 konstaton me mbylljen e vitit shkollor. Gjatë periudhës Shtator 2025-Qershor 2026 janë mare masat e nevojshme për mbarëvajtjen e kushteve dhe funksionimin e cdo godine.

Më poshtë janë paraqitur disa nga hapat e ndjekur në lidhje me ecurinë e punës gjatë vitit 2025-2026:

- Riparime hidraulike, zëvëndësimi i te gjitha grupeve të dëmtuara si rubineta, tubo fleksibel në shkarkimet ku ka pasur probleme, riparime pompash k1,k2 (konvikti).
- Zëvëndësimin komplet te ndricuesave, llambave të djegura, zëvëndësim celsash, priza të dëmtuara, sigurimi i ndricimit të jashtëm të gjimnazit "Hasan Tahsini" si dhe elektrike në cdo godine që përmban bashkia .
- Lyerje me boje në cdo godine në ambjente të brendshme dhe të jashtme.
- Marangozi, rregullime bankash, tavolina ,karrike dhe dyer të shkollave "9-Tetori", Ksamil, Gjashtë, Cukë
- Duroaluminet, Rregullim xhamash, portash, bravash ku ishte e nevojshme,
- Zëvëndësim pllakash të dëmtuara nëpër shkolla,
- U realizua në dy shkolla "Kopshi botanik" : Shkolla "9-Tetori" dhe Shkolla ne Cukë

- Gjatë gjithë vitit janë realizuar aktivitete të ndryshme në kuadër të ditëve të vecanta ndërkombëtare nëpër kopshte dhe shkollat e qytetit me qëllim sensibilizimin e fëmijëve mbi tematiaka të ndryshme sociale si më poshte:



Nr	Emri I aktivitetit	Qellimi	Data	Institucioni
1	Aktivitet "Vjeshta poetike" me nxenes te shkollave te qytetit	Diskutime me nxenes te qytetit per te promovuar krijimet e tyre dhe per te rritur interaktivitetin dhe nxitur brezin e ri drejt leximit.	09.09.2025	Bashkia Sarande, Gjimnazi "Hasan Tahsini" dhe QKF.
2	Aktivitet me teme: "Thelbi I ligjit, sjellja konsumatore dhe siguria e femijeve"	Edukimi si themel per te formuar sjellje te drejta dhe te ndergjegjshme konsumatore qe ne moshe te hershme.	18.09.2025	Bashkia Sarande, Zyra e Mbrojtjes se Konsumatorit dhe shkolla "Adem Sheme"

14	Permbyllje e vjeshtes poetike ne "Muajin e letersise" me nxenes te shkolles Adem Sheme.	Promovimi I letersise se shkruar ne brezat e rinj.	30.10.2025	Bashkia Sarande ne bashkepunim me shkollen "Adem Sheme "
15	Mbremje nderkulturore franceze ne sarande ne kuader te marreveshje mes Bashise Sarande dhe organizates franceze "Pertej barrierave"	Shkembime kulturore mes 2 shteteve partnere	07.11.2025	Bashkia Sarande ne bashkepunim me organizaten "Pertej barrierave".
16	Aktivitet ne kuader te "Dites Boterore te te Drejtave te Femijeve	Ndergjegjesimi I nxeneseve ne lidhje me te drejtat e tyre, sigurine gjate levizjes ne shkolle dhe perdorimin e internetit te sigurte.	18.11.2025	Shkolla "Shefqet Sulejmani" ne bashkepunim me Bashkine Sarande
17	Takim nderinstitucional ne kuader te ndergjegjesimit kunder dhunes me baze gjinore.	Rritja e ndergjegjesimit mbi dhunen me baze gjinore	25.11.2025	Shkolla "Adem Sheme" ne bashkepunim me DAAF, Prokurorine, Shoqata Jona, PMF
18	Konkursi I hiostorise midis klasave te 9-ta te shkolle "9 Tetori"	Konkurs historie midis 2 klasave te 9-ta te shkolles 9-Tetori per te promovuar vlerat historike te Kombit Shqiptar	25.11.2025	Shkolla "9 Tetori" ne bashkepunim me Bashkine Sarande
19	Asktivitet festiv per festat e nentorit me femije te qendres kulturore te Bashkise Sarande	Perkujtimore e shpallje se pavaresise se vendit me ane te interpretimeve artistike te femijeve te qendres kulturore.	28.11.2025	Qendra Kulturore e Femijeve ne bashkepunim me Bashkine Sarande.
20	Aktivitet socio-kulturor ne kuader te festave te fundvitit.	Aktivitet me valle e kenge me nxene ste shkollave	16..12.2025	Shkolla "Adem Sheme" ne bashkepunim me DAAF
21	Aktivitet socio-kulturor ne kuader te festave te fundvitit.	Aktivitet me valle e kenge me nxenes te shkollave	17.12.2025	Shkolla "Antonio Athanasi" ne bashkepunim me DAAF
22	Aktivitet socio-kulturor ne kuader te festave te fundvitit.	Aktivitet me valle e kenge me nxene ste shkollave	18.12.2025	Shkolla "9 Tetori" ne bashkepunim me DAAF
23	Aktivitet socio-kulturor ne kuader te festave te fundvitit.	Aktivitet me valle e kenge me nxenest e shkollave	19.12.2025	"Qendra Kulturore e Femijeve" ne bashkepunim me DAAF
24	Aktivitet socio-kulturor ne kuader te festave te fundvitit.	Aktivitet me valle e kenge me nxene ste shkollave	20.12.2025	"Qendra Kulturore e Bashkise Sarande" ne bashkepunim me DAAF

35	22 Prill "Dita e tTokes"	Ndergjesimi I komunitetit mbi rendesine e mjedisit te paster dhe kultivimit te tokes.	22.04.2026	DAAF ne bashkepunim me shkollen 9-vjecare Cuke.
36	Zhvillimi I Kampionatit te Volejbollit ndermjet shkollave te qytetit.	Rendesia e aktivitetit fizik ne shendetin e te rinjve.	24.04.2026	Shkollat e qytetetit ne bashkepujnim me Bashkine Sarande.
37	Aksioni Nderkombetar I Pastrimit para nisjes se sezonit turistik.	Ndergjegjesimi I komunitetit per rendesine e mjedisit te paster,	24.04.2026	Bashkia Sarande dhe institucionet vartese te saj.
38	Dita Nderkombetare e Tradites se Valleve	Ruajtja e tradites kulturore dhe percjellja e saj ne brezin e ri.	29.04.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me shkollat 9-vjecare te qytetit.
39	Aktivitet sportiv me femijet e shkollave te qytetit	Kampionati I futbollit mes shkollave 9 -vjecare	11.05.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me shkollat 9 vjecare
40	Debat mes nxenesve te shkolles "Adem Sheme"	Te forcohet komunikimi nxenes-prinder. Krijimi I urave te komunikimit.	01.06.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me shkollen "Adem Sheme" dhe "Qendren Rinore"
41	Aktivitet festiv per rastin e festes se 1 qershorit.	Organzimi I festes se "1 Qershorit" me kopshtet e cerdheve e qytetit.	01.06.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me kopshtet dhe cerdhen e qytetit.
42	Aktivitet me kenge e valle me femije te qendres kulturore	Fesdtivali I kengeve dhe valleve ne kuader te festes se "1 Qershorit"	01.06.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me Qendren Kultorore te Femijeve.
43	Aktivitet ndergjegjesues " Dita Nderkombetare e Mjedisit"	Aktivitet ndergjegjesues mbi rendesine e mbrojtjes se natyres, re4duktimit te ndotjes dhe ruajtjes se burimeve natyrore.	05.06.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me shkollat e qytetit.
44	Aktivitet kulturor "Piktori I vogel"	Promovimi I talenteve te reja ne fushen e piktures.	09.06.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me shkollat e qytetit.
45	Koncert me violina ne shetitoren e qytetit.	Shfaqje artistike ne bulevevard nga femije te Qendres Kulturore.	24.06.2026	Bashkia Sarande ne bashkepunim me Qendren Kultorore te Femijeve.
46	Aktivitet kulturor "Artisti I vogel"	Promovimi I talenteve te reja ne fushen e piktures.	02.07.2025	Bashkia Sarande ne bashkepunim me Qendren Kultorore te Femijeve.

Masat e marra për mbarëvajtjen dhe funksionimin e fillimit të vitit të ri shkollor 2026-2027.

Drejtoria e Arsimit Dhe Administrimit Finaciar ka në varësi një total prej 23 godinash të cilat administrohen dhe monitorohen nga vetë drejtoria përgjatë gjithë vitit.

- 1 cerdhe ku frekuentojnë 140 fëmijë.
- 11 kopshte publike dhe dy private ku frekuentojnë 720 femije.
- 8 shkolla 9-vjecare publike, 1 jo publike që frejuentojne rreth 2245 nxënës.
- 2 gjimnaze publik dhe 1 privat qe frekuentojnë rreth 660 nxënës.
- 1 shkollë profesionale ku frekuentojnë 144 nxënës.

Listuar si më poshtë të gjitha ndërhyrjet që realizohen në kuadër të funksionimit dhe mirëmbajtjes së këtyre godinave apo institucioneve.

- Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar ka planifikuar gjithcka mbështetur plotësisht në Urdhrin Nr. 31 datë 28.01.2020 te MAS.
- Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Fininanciar së bashku me Policinë Bashkiake dhe Drejtorët e shkollave në kuader të Paketës së Sigurisë do të sigurojë evidentimin për cdo institucion shkollor për marrjen e masave për ezaurimin e cdo problematike sikunder ndodh cdo fillim viti akademik.
- Ju vemë në dijeni se cerdhja dhe kopshtet në qytetit e Sarandes janë të hapura edhe gjatë sezonit të verës.
- Kanë përfunduar regjistrimet për kopshte dhe cerdhe ku konstaton një numër prej 183 fëmijësh në kopshtet dhe cerdhen në varësi të Bashkisë Sarandë.
- Vazhdon procesi i mirëmbajtjes së kopshteve dhe cerdhes për cdo problematik të hasur.
- Janë drejt përfundimit ndërhyrjet në ambientet sportive të jashtme të shkollave, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive.
- Janë pastruar të gjitha ambjentet dhe jemi në proces disifektimi të ambjenteve, sistemimit dhe mirëmbajtjes së tyre përreth institucioneve arsimore.
- Monitorim i vazhdueshem në kopshte dhe cerdhe për ofrimin e shërbimit në komunitet mbikqyrur me punonjës social dhe specilistë të arsimit, shoqëruar me evidenca përkatëse mujore.

edhe produkteve dezifektant të nevojshme për paisjen e institucioneve dhe të stafit në varësi të Bashkisë Sarandë.

- Për masat higjeno-sanitare të marra në institucionet e arsimit parashkollor, sistemin arsimor të detyruar dhe sistemin arsimor të mesëm në varësi të Bashkisë Sarandë ju informojmë se: Sherbimet 3D Dezifektimin-Dezinsektimin-Deratizimin në ambjentet e brëndshme dhe të jashtme të godinave të çerdhes, kopshteve, shkollave dhe konviktit të administuar nga DAAF janë në proces blerje dhe sipas planit përfundojnë brenda afateve. Nëpërmjet sherbimi 3D mundësohet pajisja me certifikatë 3D të institucioneve arsimore sipas kërkesave të Ministrisë Së Shëndetësisë.
- Vazhdon bashkëpunimi i ndërsjelltë me Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe drejtuesit e institucioneve arsimore për evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave që mund të lindin.
- Bashkia ka garantuar mbështetjen e nevojshme për institucionet arsimore për krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin normal të procesit mësimor.
- Hartimi I rregulloreve të brëndshme nga drejtoritë e kopshteve përkjatëse me qëllim sigurimin e kuadrit të brëndshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së kopshteve të sigurojë rregulla të njëjta për disiplinimin e fëmijëvë dhe administratës si dhe të garantojë pjesmarrjen aktive të fëmjjëve në procesin mësimor-edukativ dhe në aktivitete të tjera. Kjo rregullore ka synim të përcaktojë të drejtat, obligimet, detyrimet, veprimet e ndaluara, vijushmërinë në procesin mësimor-edukativ, përcakton kodin etijk të sjelljes së stafit, komunikimin, orarin e punës duke pasur në fokus interesin më të lartë të fëmijëve.
- Mbështetja me bursa e nxënësve që vijnë nga familje me kushte socio-ekonomike, komunitetin rom dhe egjiprian, nxënës me PAK, nxënës me status jetimi dhe nxënës në rrezik braktisje shkolle. Ky lloj shërbimi ka si qëllim ndihmën dhe mbështetjen direkte për nxënësit në mënyrë që të sigurohet përfshirje e barabartë në procesin mësimor dhe të reduktohen barrierat sociale që ndikojnë në zhvillimin dhe performancën e tyre në shkollë.
- Bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore "Eqerem Cabej" në Gjirokastër mbi miratimin e kryerjes së praktikës profesionale të studimeve Bachelor në "Mësuesi për Arsmin Parashkollor" nëpër kopshtet dhe cerdhen e qytetit. .



Informacioni mbi Paketën e Sigurisë në shkolla:

Drejtoria e Arsimit dhe Administrimit Financiar së bashku me Policinë Bashkiake dhe Drejtorët e shkollave në kuader të Pakëtës së Sigurisë kanë bërë azhornimin për cdo institucion shkollor për marrjen e masave për ezaurimin e cdo problematike.

Masat e mara listuar si më poshtë:

- Gjimnazi "Hasan Tahsini", Gjimnazi "5-Dëshmorët" Ksamil, shkolla "Adem Sheme", shkolla "9-Tetori", shkolla "9-vjecare Ksamil" janë pajisur me stafin mbështetës dhe oficer sigurie ndërsa shkolla "Shefqet Sulejmani" dhe shkolla "9-vjecare Cuke" janë të pajisura me stafin mbështetës pa oficer sigurie por vëzhgohet me kamera.
- Kamerat e sigurisë janë vendosur pothuajse në të gjithë perimetrin e shkollave.
- Është përfunduar sinjalistika rrugore pranë institucioneve arsimore, ku janë realizuar vijëzimet përkatëse pranë çdo shkolle, me qëllim rritjen e sigurisë së nxënësve dhe menaxhimin e qarkullimit.
- Janë realizuar punimet për sistemimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të jashtme të institucioneve arsimore.

- Edukatere me titull specialis janë13.
- Edukatore me titull të kualifikuar janë 6.
- Edukatore mbështetëse për fëmijë me aftësi ndryshe janë 7 te cilat merren në punë nga portali.
- Numri i psikologeve në shkollat e Bashkisë është 12 psikologe te emëruara dhe 1 psikologe me kontratë, ndërsa në kopshte operon nje punonjëse sociale e emëruar pranë DAAF.
- Numri i mësuesve mbështetës në shkollat e qytetit për fëmijët me aftësi ndryshe është 23.
- Janë organizuar disa takime në Bashki si dhe disa mbledhje GTN (Grupi Teknik Ndersektorial ku perfshihen 21 institucione) në rastet me risk të moderuar, mbështetje dhe monitorim në vazhdim që nuk konsiderohen takime por ndjekje e domozdoshme e rasteve.
- Gjithashtu është hartuar Analiza e Planit Arsimor Parauniversitar 3-vjecar e kaluar në muajin gusht të vitit 2025 me vendim të Këshillit Bashkiak ku na jep një panoramë të qartë të konstekstin administrativë I cili luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin local, përfshirë dhe planifikimin dhe shërbimet e arsimit parashkollor në të gjithë territorin e Bashkise Sarandë.
- Për të parandaluar Bullizimin dhe dhunën fizike dhe verbael në shkolla si një fenomen global shumë shqetësues, realizohen sesione informuese dhe fushata ndërgjegjësuese në cdo shkollë në mënyrë të vazhduar duke bashkëpunuar me psikologet dhe aktore të tjere psh: OJF, oficer i policisë, PMF, Koordinatori i te miturve.
- Gjithashtu nga DAAF organizohen rreth 50 aktivitete në vit me tematika sociale të ndryshme me qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin e të miturve.
- Institucionalizimin dhe funksionimin e strukturave menaxhuese pjesmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore , përfshirë Bordin e institucionit, Bordin e cdo grupimi në kopësht , Këshillin e prindërve dhe Komisionin e Sigurisë dhe Mjedisit në kopshte dhe shkolla. Kjo ka si qëllim zhvillimin dhe funksionalizimin konkret të strukturave menaxhuese në institicionet arsimore.


Pikat e forta të Drejtorisë së Arsimit dhe Administrimit Financiar:

- Drejtoria jonë bën të mundur regjistrimin e fëmijëve përtej vitit akademik, edhe në periudha të mëvonshme duke qenë se një pjesë e popullsisë janë të punësuar në punë sezonale.
- Bashkëpunimi me Organizata Jo Fitimprurëse të huaja si organizata "Beyond Barriers' duke ofruar vullnetarë nga shtete të ndryshme për të ofruar aktivitete psiko-sociale, terapi loje dhe aktivitete të ndryshme educative me shkollat, konviktin, QKF, shtëpia e fëmijës, Qëndra Multifunksionale per Zhvillimin e Fëmijëve dhe Fuqizimin e famjiljes, Qëndra e Zhvillim, Qëndrën Rinore dhe me fëmijë të ciklit parashkollor në të gjitha kopshtet e qytetit.
- Gjithashtu duhet përmendur dhe bashkëpunimi me "Fondacionin Lidia", bashkëpunim I cili ka si qëllim ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë për fëmijët me aftësi ndryshe, në mënyrë që të sigurohet përfshirje e barabartë në procesin mësimor dhe të reduktohen barrierat sociale që ndiokojnë në zhvillimin dhe performancën e tyre mësimore. Në kopshtet dhe cerdhen e Bashkisë Sarandë ofrohet monitorim dhe ndjekje hap pas hapi e femijeve me aftësi ndryshe, proces ky që monitorohet nga punonjësja sociale dhe ndiqet deri në marrjen e paaftësisë nga Qëndra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për fëmijë deri në marrjen e diagnozës finale. Më pas ky proces monitorohet nga mësueset mbështetëse të identifikuara nga portal arsimor I ZVA-së duke zbatur Programet Edukative Individuale për gjithësecilin fëmijë.
- Bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore "Eqerem Cabej" në Gjirokastër mbi miratimin e kryerjes së praktikës profesionale të studimeve Bachelor në "Mësuesi për Arsmin Parashkollor" nëpër kopshtet dhe cerdhen e qytetit. .
- Ofrohet shërbimi I kopshtit pa pagesë për fëmijët të cilët janë ne kushte te vështira socio-ekonomike me miratimin e Keshillit Bashkiak.
- Gjithashtu drejtoria jonë bën të mundur realizimin e bursave 100% për nxënësit e shkollës së mesme "Antonio Athanasi" dhe shkollave te tjera 9-vjecare dhe gjimnazet e qytetit te cilët janë në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me status jetimi. Për fëmijët e komunitetit rom të shkollës së Cukës ofrohet bursë për rrezik braktisje të shkollës duke zbatuar kriteret sipas VKM 666 për përfitimin e bursave.
- Ofrojmë akomodim falas për nxënës të shkollës "Antonio Athanasi" pranë konviktit të kësaj shkolle.













Duke ju falënderuar,

DREJTOR

Teuta Maze